

Informatë për prindin 7.5.

Mirë se vini në mësimin në klasë duke filluar nga 14.5

Pjesa e mbetur në pranverë e mësimin klasor është me rëndësi si nga pikëpamja e mirëqenjes së nxënësve po edhe e raporteve shoqërore. Nxënësit do të përgatiten për tu kthyer në shkollë edhe gjatë kohës së mësimin nga distanca. Me nxënësit do të vlerësohet kjo fazë e mësimin dhe do të rezervohet një kohë për bisedë të përbashkët për metodat e ndryshuara të funksionimit të shkollës dhe për ndjenjat e nxënësve.

Vantaa i respekton rekomandimet shtetërore për kthimin në shkollë duke filluar nga 14.5.2020. Sipas vendimit të këshillit shtetëror pjesëmarrja në mësimin në shkollë është e sigurt kur mësimi organizohet në përputhje me kërkesat për mbajtje të higjenes dhe respektimit të tyre.

Organizimi i mësimin

Mësimi realizohet sipas metodave mësimore që përshtaten sipas nevojë. Çështja e distancës realizohet ashtu, që nxënës në të njëjtën hapësirë do të ketë më pakë se më parë pra do të shtohet distanca fizike mes nxënësve dhe ndaj mësuesit. Grupet për mësim do të mbahen të ndara gjatë gjithë kohës së shkollës.

Të gjitha shkollat janë në funksion dhe gjatë mësimin do të respektohen udhëzimet e përgjithëshme të siguris për mënjanimin e kontakteve fizike të panevojshme. Përveç në hapësirat e veta shkollërore një pjesë e nxënësve do të mësojnë edhe në hapësirat e shkollës tjetër si dhe në hapësirat e të rinjëve që janë afër shkollës së tyre. Kështu e kemi shtue edhe distancën mes hapësirave të shkollës.

Edhe fëmijët edhe të rriturit do t'i pastrojnë duart çdo herë kur të vijnë në shkollë, si dhe para se të nisen për në shtëpi. Poashtu duart pastrohen para ngrënjes së ushqimit, çdo herë pas ardhjes nga jashtë për të hy brenda, si dhe çdo herë pas testimit apo kollitjes, apo kur është e dukshme se duart janë të papastra. Duart pas larjes thahen me shami letre për përdorim të njëhershëm.

Ngrënja e ushqimit organizohet me klasën apo grupin e vetë duke pasur kujdes të veçantë për higjën. Mes klasëve për shembull i pastrojmë linjat e ushqimit, i ndërrojmë veglat e marrjes së ushqimit dhe i dezinfektojmë paikat e shërbimit të pijeve.

Pjesëmarrja e nxënësit në nxënjen e mësimin

Nxënësi duhet të marrë pjesë në nxënjen e mësimin, vetëm nëse për arsye të veçanta ai është liruar përkohësisht nga vijimi në shkollë.

Në shkollë nuk lejohet të vijë i sëmurë

Për asnjë nxënës apo të rritur nuk lejohet të vijë në shkollë, nëse ai ka çfarë do shenja që tregojnë simptoma të sëmundjes. Nëse fëmija sëmurë gjatë kohës së ditës, fëmija me simptoma menjëherë do të bartet nga kujdestari në një hapësirë tjetër që të pret derisa të vijë prindi. Për simptomat duhet të kontaktohet qendra e vetë shëndetësore për tu pranuar atje për bërjen e testit për koronavirusin sipas udhëzimeve të dhëna.

Nëse nxënësi i takon grupit me rrezikshmëri në raport me koronavirusin

Spitalet universitare në bashkëpunim me Institutin e mirëqenjes shëndetësore (THL) kanë hartuar listën e atyre sëmundjeve, që fëmijët të cilët vuajnë prej tyre i takojnë grupit me rrezikshmëri infektimi që nëse sëmurë nga koronavirusi do të kenë një formë serioze të sëmundjes. Të dhëna shtesë për grupet e rrezikuara gjenden në këtë [web-link](#).

Nëse fëmija i juaj është në trajtim mjekësorë në spitalin universitar në Helsinki (HUS) për shkak të sëmundjeve të përmendura më lartë, kërkojmë nga ju që të na sjellni vërtetimin mjekësor për trajtim të fëmijës në HUS.

Në rast se fëmija nuk ka pasur më herët kufizime me mësimin në klasë në raport me gripin apo me RSV-periudhën e sëmundjes së rrugëve të frymëmarrjes, nuk ka arsye që të mos vijë në shkollë poashtu edhe gjatë kohës së koronavirusit.

Nxënësve që mungojnë për shkak se i takojnë grupit me rrezikshmëri nga infektimi ju lëshohet një vendim sipas ligjit të mësimin fillor dhe të mesëm të ulët paragrafi i 18§:të për organizimin e veçantë të mësimin dhe nxënësit me këtë rast kanë të drejtën e mësimin në pjesë të përshtatura nga distanca. Në këtë rast prindi duhet të kontaktoj me drejtorin e shkollës për marrëveshje për organizimin e mësimin.

Nëse në familjen e nxënësit ka antar familje që i takon grupit me rrezik nga infektimi

Instituti i mirëqenjes shëndetësore (THL) ka hartuar [listën](#) e sëmundjeve, të cilat mundin me i rrezikue seriozisht të rriturit në rastë se ata infektohen me koronavirusin. Këto sëmundje, të cilat në masë efektive e keqësojnë funksionimin e mushkërive dhe të zembrës apo imunitetin e organizmit, janë për shembull:

- Sëmundja e zembrës e shkallës së vështirë
- Sëmundja e mushkërive në baraspeshë të keqësuar trajtimi
- Diabetikët, ku ndërlidhen edhe deformime organeve trupore
- Sëmundje kronike e funksionimit të mëlçis dhe veshkeve
- Sëmundja që dobëson imunitetin sikurse është trajtimi aktiv me kemoterapi i sëmundjes së kancerit
- Terapia që dëmton rëndë imunitetin e organizmit (për shembull trajtimi në dozë të lartë me kortizon).

Në rast se antari i familjes së nxënësit ka nga sëmundjet e përmendura më lartë dhe prindi shpresonë, që nxënësi për këtë arsye të mos merr pjesë në mësimin në klasë, prindi mundet të kërkoj vërtetimin për këtë. Vërtetimi merret duke kontaktuar antari që ka pasur trajtim mjekësor në HUS apo në qendrën shëndetësore në Vantaa. Ata që janë trajtuar në qendrën shëndetësore në Vantaa mundin të kontaktojnë në mënyrë elektronike përmes Maisa web-portalit. Këtu është [web-linku](#) i sistemit Maisa.

Mesazhi i dërguar përmes Maisa duhet të përmbajë informacionin si në vazhdim: A) Më duhet vërtetimi i shkollës për fëmijën tim. B) Trego cili antar i familjes je / për cilin antar të mitur të familjes po e rregullon këtë çështje. C) Në bazë të cilës sëmundje kërkohet vërtetimi.

Do të merrni vërtetimin e kërkuar nga ju për shkak të shkollës nga sistemi Maisa.

Për nxënësin që mungon nga shkolla për shkak se një antar i familjes i takon grupit me rrezikshmëri për shkak të infektimit i bëhet një vendim bazuar në ligjin për mësimin fillor dhe të mesëm të ulët paragrafi i 18§:të për mësim të veçantë dhe nxënësi ka të drejtën në mësimin me pjesë të përshtatura nga distanca. Në këso situatë prindi duhet të kontaktoj drejtorin e shkollës për marrëveshje lidhur me organizimin e mësimin.

Mungesat tjera

Nëse nevojitet leja për të munguar ajo kërkohet gjithnjë në bazë të mënyrës së rëndomtë të mungesës nga shkolla. Pas kalimit me mësimin në klasë mësimi nga distanca nuk organizohet tani më për nxënësit që mungojnë.

Transporti për në shkollë

Pas hapjes së shkollave me 14.5. transportimi i nxënësve në shkollë vazhdon në bazë të vendimeve aktuale që janë në fuqi. Shkollat i informojnë sipërmarrjet e taksive për orarin e vitit shkollor si dhe vendin e organizimit të mësimit, në rast se aty ka ndryshime. Sipërmarrjet e taksive i informojnë prindërit për kohën e transportit normalisht si më parë.

Prindërit duhet të anulojnë në mënyrën e njejtë si më parë transportin me taksì sipërmarrjeve të taksive, nëse nxënësi mungon nga shkolla.

Në linjat publike të transportit ka pasur ndryshime në këtë kohë pranvere. Nëse nxënësit i është lëshuar kartela e udhëtimit për nxënës, është me rëndësi me ja qartësue në kohë të duhur rrugën deri në shkollë me ato mjete publike që i përdorin.

Aktivite gjatë kohës së paraditës dhe pasditës

Aktiviteti i nxënësve paradite dhe pasdite vazhdon në këto dy javët e fundit normalisht. Në rast se fëmija i juaj ka pasur këtë vit shkollor vendim për aktivitet gjatë pasditës dhe i nevojitet trajtim për këtë, kontakto direkt me palën në shkollën e fëmijës suaj që e organizon këtë aktivitet të pasditës.

Në klubet e pasditeve mundet me pas disa grupe të nxënësve. Në klube do të respektohet mbajtja e distancës së sigurisë.

Kuratori i shkollës dhe shërbimi psikologjikë

Kuratori dhe shërbimi psikologjikë janë në shërbim të nxënësve, prindërve dhe personelit të shkollës. Është me rëndësi të veçantë, që nxënësit, prindërit dhe mësuesit të flasin për shqetësimet e tyre me personelin për kujdesje ndaj nxënësve me një bisedë për tu kuptuar si duhet. Psikologët dhe kuratorët të koncentrohen në takime me nxënësit dhe në mbështetjen e punës së mësuesëve. Në mësimin fillestar punohet nëpër shkollat e veta. Objektivë është që të ju organizohet mbështetje në mësim atyre nxënësve, për të cilët mësuesit ose prindërit apo vetë nxënësit kanë brengosje për të. Personeli i shkollës, fëmijët, të rinjët dhe familjet mundën sipas nevojë të kontaktojnë me kuratorin dhe psikologun e shkollës së tyre përmes Wilma apo me telefon. Psikologët dhe kuratorët vazhdojnë punën e tyre me nxënësit edhe gjatë qershorit dhe kthehen në punë në pjesën e parë të gushtit.

Shkollat informojnë më detajisht për organizimin

Nëpër shkolla bëhen organizime sipas nevojave të shkollës. Në orarin e fillimit dhe në organizimin e hapësirave të shkollave mund të ketë ndryshime. Shkollat do të njoftojnë më detajisht për organizimin e mësimit prindërit në ditët në vijimë, më së fundi deri më 12.5.

Për më shumë informata lexo nga web-faqet e Ministris së Arsimit: <https://www.oph.fi/fi/koulutus-ja-tutkinnot/145-alkaen-lahiovetukseen-palaaminen-perusopetuksessa>

Derisa viti shkollor po shkon drejtë përfundimi, shpresojmë për mbështetjen tuj deri në fund. Së bashku edhe këtu do të ja dalim!

Ilkka Kalo, drejtues i mësimit të gjuhës finlandeze në mësimin fillor dhe të mesëm të ulët
Anders Vikström, drejtues i shërbimit rajonal në gjuhën suedeze